

PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 30.11.2023

Kryesuesi i mbledhjes është: Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi

Ora e hapjes së mbledhjes: 12:00

Zhvillimi i mbledhjes: në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 26

Sekretari i Këshillit deklaroi kuorumin prej këshilltarësh: 26

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: zv/kryetari Kletjon Kita dhe drejtorë

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 1

Kryetari i Këshillit A. Verushi: Fillojmë këtë mbledhje të këshillit bashkiak ashtu si jeni njoftuar, materialet duhet të ishin te plota por për shkak të dakortësisë edhe të kryesisë edhe të grupeve të komisionit meqënëse dita e hënë ishte pushim dhe mbledhja e komisioneve nuk mund të zhvillohej jeni njoftuar që pikat e tjera do të zhvillohen në datën 7 dhjetor.

Pika 1 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Kryetari i Këshillit A. Verushi: Pika e 2 e rendit të ditës, ju lutem komisioni.

Këshilltare E. Mitre: Duke parë materialin që e kemi në dispozicion të gjithë jemi shumë dakort që ky material ti kalojë këshillit për miratim, në këtë muaj kemi 64 familje të përzgjedhura sipas sistemit të pikëzimit që përfitojnë shumën 225 mijë e 87 lekë po nga ky fond përfitojnë kompesim të energjisë elektrike 28 familje me shumën 32 mijë e 176 lekë cdo gjë ka bazën e sa ligjore brenda normave, pagesa totale nga 6% e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike plus energji është 258 mijë e 63 lekë ne si komision jemi dakort që materiali të miraohet nga këshilli.

Pika 2 e rendit të ditës

MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1 –30 TETOR 2023.

Hidhet ne votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Kryetari i KëshillitA.Verushi: Kalojmë në pikën tjetër kërkesa, aneksa të qytetarëve.

Kryetari i KëshillitA.Verushi: Do t'ju lutesha që personat të cilët ju citoni nuk janë prezentë dhe që janë ne dijeni të problemit tuaj, mos përmendim persona të cilët nuk ndodhen këtu. Detyra jonë është të meremi me probemin tuaj me drejtorite përkatëse, me hapësirat që ju ka dhënë kjo drejtori por ju të fyejm persona të cilët nuk ndodhen, të jemi te kujdesëm në fjalor. Në mbledhjen tjetër të radhës kur të jetë i pranishëm dhe kryetari dhe drejtoria përkatëse në mbledhjen e radhës do ta diskutojmë problemin, nëqoftëse ka ndonjë gjë shtesë ndryshe nga herët e tjera do të dëgjojm por pa fyer askënd.

Qytetarja: Ndihem e fyer sepse me ka ofenduar ne zyrë.

Kryetari i KëshillitA.Verushi:Të gjithë janë qytetarë të cilët kanë të drejtë te strehohen dhe përfiojne banesa ashtu sikurse dhe ju, ju doni të ndryshoni banesën për shkak se nuk ju pëlqen mjedisi.

Qytetarja: Që kur kam hyrë në këtë banese ajo ka defekt sepse është e gjitha myk dhe unë kam njoftuar komisionin që të vijë te shohë hyrjen sepse është e gjitha myk.

Kryetari i KëshillitA.Verushi: E kuptova shqetësimin tuaj, ne do ti japim një zgjidhje problemit tuaj bashkë me drejtorinë përkatëse.

Qytetarja: Unë me ju jam shumë dakort, unë ja bëra dhe kryetarit letrën dhe ndryshe kishte shkrojtur në letër dhe ndryshe tha kur i shkova në zyrë.

Kryetari i KëshillitA.Verushi: Me një grup këshilltaresh ne shkuam në një nga bizneset që kanë një numër relativisht të madh të zonjave që punojnë në këtë biznes, falenderoj biznesin i cili na

mikpriti për të bërë këtë fushtatë sensibilizuese duke u shoqëruar dhe nga një mjekë onkologë ish kolegia jonë në këshill ja vlejti me thënë të drejtën, e cuam deri në fun nismën që kishim ndërmarr jo vetëm që bëme sensibilizimin në fabrike por njëkohësisht krijuam mundësinë që të bënim mamografinë me një kalendar të përcaktuar dhe fatmirësisht pjesa më e madhe e tyre nuk kishin probleme dhe ato probleme të vogla të cilat u gjykuan nga mjekët për të bërë ekografinë ju shkuam deri në fund, unë dhe koleget e mia jemi shumë të lumtura që kemi bërë këtë sensibilizim, ne do të krijojmë një kalendar tjetër aktivitetesh të cilat do jemi në shërbim të komunitetit. Do doja të informoju gjithashtu këshillin që në vizitën studimore që ne bëme në 2 nga bashkitë kanë qënë vizita studimore të vlefshme, grupi i këshilltareve të cilë ju bashkangjiten këtij turi në veriun e Shqipërisë janë vetë të ndergjegjshëm se cili që përfitimi i këtyre komunikimeve me këshillat bashkiak për të njohur më shumë nga këto qytete, këto forcojnë dhe komunikimet midis njeri- tjetrit dhe afrimin dhe lehtësimin e problematikave që mund të kemi gjithsecili kështu që unë gjej rastin të falenderoj këshilltarët të cilët u bënë pjesë e këtij udhëtimi.

Edhe diçka tjetër edhe Këshilli i Vlorës dhe Bulqizës kanë kërkuar që të bëjnë një vizitë studimore në Korçë dhe Vlora kërkoi që pjesë e ftesës të bërë nga këshilli të jetë përfshirë dhe ekzekutivi kështu që ne patjetër që do i mirëpresim. Unë do të kërkoja nga këshilltarët që me të përcaktuar datën të jenë pjesë e këtyre takimeve jo vetëm këshilltarët por dhe administrata e këshillit sipas drejtorive që kanë të jenë pjesë e këtij takimi, besoj se do jenë rreth datës 15 ose 16 ne do të ndërtojmë dhe një kalendar vizitash për qytetin sepse ne kemi çfarë tju ofrojmë.

Këshilltar E.Bregu: Në lidhje me vizitën studimore të kryer në Shkodër dhe Lezhë dhe gjithashtu me trajnimin e këshilltarëve, i shoh shumë të vlefshme këto aktivitete për të ndihmuar këshilltarët të bëjnë rolin e tyre, sic e thatë dhe ju do ishte mirë që të kishte bashkëpunim midis këshillit dhe ekzekutivit edhe unë jam dakort. Po shikoj që kryetari i bashkisë ka disa radhë që nuk vjen në mbledhje edhe pse ne kemi lënë disa çështje pika të ndryshme për të diskutuar dhe i kemi shtyrë 3 herë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kryetari sa herë është në Korçë është i pranishëm në mbledhje dhe asnjëherë nuk i neglizhon mbledhjet e këshillit por meqënëse ndodhet në një detyrë jashtë Shqipërisë nuk ka qënë në mbledhjen e këshillit dhe përfaqësohet nga ZV. Kryetari dhe është e njëjta gjë dhe në këtë rast do kërkoja të ishim më të kujdesshëm nuk është se kryetari nuk do dhe nuk do të merret me shqetësimet që ju keni ngritur por ai fizikisht nuk ndodhet këtu. Mbledhjet janë të këshillit kryetari thirret për t'ju thënë përgjigje problemeve që ju keni.

Këshilltar E.Bregu: Kemi tre rradhë që e kërkojmë çështjet dihen, është rradha e tretë që kryetari nuk paraqitet, mbledhjet janë bërë me kërkesë të kryetarit, kur kryetari nuk është prezent të njoftojë këshilltarët duke pasur parasysh që ka çështje të cilat kërkojnë patjetër prezencën e kryetarit. Javën tjetër në datën 7 dhjetor është caktuar një mbledhje, kryesia e këshillit është mbledhur dhe ka vendosur që ta shtyjë për në datën 7 disa pika të rendit të ditës. A e keni proces verbalin e mbledhjes të kryesisë dhe së dyti në datën 7 do të shqyrtohen disa çështje të cilat kërkojnë të zhvillohen konsultime të cilat janë në datën 11 a duket pa sens kjo datë me atë rend dite?

Kryetari i Këshillit A. Verushi: Edhe njëherë po ju sqaroj takimet pas datës 11 kanë të bëjnë me buxhetin e 2024, projektbuxheti afatmesem 2024-2026 ku përfshihet dhe buxheti 2024 është miratuar nga ky këshill. Nëqoftëse gjatë konsultimeve do të ketë gjetje të tjera nga ana e këshilltarëve të cilat do të donin një replikim në buxhetin 2024 apo dhe në PBA për këtë do të bëhen konsultimet në mënyrë që kur të vijë data për të miratuar buxhetin ne i kemi të pasqyruara këto që ju do të sillni. Ne i kemi shpërndarë kemi mundësinë që gjatë kësaj peridhe kohe të pyeten grupet e interesit që ju mendoni që çënohen nga ndryshimet në paketën fiskale dhe e vendos vota nëqoftëse do të aprovohet apo jo.

Këshilltar E. Bregu: Nuk jeni e qartë sepse paketa fiskale është pjesë e buxhetit dhe konsultimet kanë lidhje me paketën fiskale.

Kryetari i Këshillit A. Verushi: Vetë ekzekutivi i ka bërë të gjitha takimet për paketën fiskale me grupet e interesit, ka qe nga tetori e cila është paraqitur edhe në WEB.

Këshilltar E. Bregu: Takimet nuk janë bërë prandaj janë rikthyer për tu ribërë sepse takimet do të bëheshin në bashkëpunim me këshillin për efekt kostosh dhe asnjëherë nuk u caktua një kalendar i plotë i takimeve dhe nuk janë kryer asnjë takim nga ekzekutivi.

Kryetari i Këshillit A. Verushi: Nëqoftëse ju nuk i keni ndjekur nuk është faji jonë, ekzekutivi bën punën e vet.

Këshilltar E. Bregu: Kemi paralajmëruar këtu në këshill kemi dhënë dhe një konferencë shtypi në data të caktuara të cilat përcaktojnë qartë dhe tregojnë të vërtetën që takimet nuk janë kryer asnjëherë.

Kryetari i Këshillit A. Verushi: Janë njoftuar këshilltarët edhe kur janë bërë takimet në Voskop në njësitë administrative ku filloj turi dhe një pjesë e këshilltarëve shkojnë aty për të bërë politike dhe me pas largohen pa qëndruar deri në fund për të parë se çfarë shqetësimesh kanë ngritur banorët e zonave dhe a janë këto shqetësime le të themi të replikuara në formën e një relacioni shkrim që do i paraqitet ekzekutivit ata janë vetë të pranishëm edhe i mbajnë por duhet të jenë vetë këshilltarët për ta paraqitur.

Këshilltar E. Bregu: Fakti që disa këshilltarë nuk kanë qënë korekte nuk justifikon mungesën e kalendarit të takimeve dhe shkeljen e procedurës nga fillimi deri në fund.

Kryetari i Këshillit A. Verushi: Nuk është faji i ekzekutivit që ne nuk i bashkangjitemi në takimet.

Këshilltar E. Bregu: Faji i ekzekutivit është sepse duhet të ishte paraqitur një kalendar takimesh.

Kryetari i Këshillit A. Verushi: Në takimin e qytetit kanë qënë vetëm katër këshilltarë dhe asnjë tjetër edhe të njoftuar dhe nëse këshilltarët nuk do ishin të njoftuar pse kanë shkuar atje do të thotë që kanë pasur njoftim.

Këshilltar P. Tollkuci: Të nderuar këshilltarë nuk është e drejtë që duke ngritur zërin do të thotë që problemi qëndron e kemi mundësinë këtu sa veta jemi këshilltarë me një gjuhë komunikimi të zgjidhim ato probleme që ne kemi. Më vjen keq që ju si përfaqësues vini në dyshim vendimin e kryesisë absolutisht që është mbledhur kryesia është marrë një vendimarrje, e dyta sigurisht që

aktivitetet janë kryer dhe ditën e hënë komisioni i ekonomisë po flisnim që mbledhjen e komisionit për punën e paketës fiskale ta bëjmë dhe të qëndrojmë dhe në ato problematika që kemi diskutuar dhe në kryesi. Duhet të dini një gjë si këshilltarë dhe unë jam këshilltar i ri por kam punuar në ekezekutiv duhet t'ju bëj me dije që një buxhet ndërtohet mbi bazën e paketës fiskale pra të ardhurat që do të realizohen në vitin 2024 realizohen mbi bazën e atyre tarifave që janë të përcaktuara në vitin paraardhës praandaj po bëjmë dhe miratimin e paketës fiskale dhe mbi këtë paketë do të realizohet dhe buxheti në seancën tjetër të mbledhjes të radhës Edhe ju si këshilltarë keni të drejtë të merni pjesë në ato komisione ku do të trajtohen problematikat që jemi duke folur.

Këshilltar E.Bregu: E kundërshtoj kritikën, nuk ka një kalendar të përcaktuar dhe mos përpiqet të bëjë politike duke treguar procedurë.

Këshilltar L.Petri: Dua të parashtroj këtu një çështje e cila nuk është pak shqetësuese në lidhje me bursat që jepen për nxënësit e nivelit parauniversitar është një vendim i këshillit të ministrave NR.666 ku parashtrohen të gjitha elementët. Ajo që unë dua të them është fakti që një kriter aty në tetor drejtoritët e shkollave duhet që të dorëzojnë tek njësi e qeverisjes vendore materialin. Njësi përgjegjëse për arsimin në fillim të çdo viti shkollor në konsultim me institucionet arsimore harton planin e shpërndarjes të bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar të cilin e dërgon në njësitë e vetqeverisjes vendore jo më vonë se muaji tetor. Këtu është e pranishme dhe zonja Etleva Tare ajo mund të flasë në vet të parë por ajo që unë dua të them që ka shqetësim nga komuniteti të cilat janë shprehur tek zyra e diskriminimit për këtë problem duke ju thënë që dokumentacioni ju kthehet mbrapa nga shkolla duke ju thënë që ju keni ndihmë ekonomike dhe nëse i qëndrojmë këtij arsytimi jemi në shkelje të këtij ligji sepse nuk mbivendos fakti që familje mer ndihmë ekonomike të anashkalojë faktin që fëmija të marr bursë, në muajin dhjetor ne si këshilltar sepse jemi pjesë e qeverisjes vendore duhet ta aprovojmë këtë gjë dhe po e ngre këtë si apel për të respektuar afatet dhe ligjin në fjalë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Do doja të dëgjoja dhe Evën për këtë problematike sepse ne duke qënë këshilltarë të vjetra ti e ke paraqitur dhe vitin e kaluar këtë problematikë një informacion për këshilltarët dhe si është zgjidhur kjo problematikë.

E.Tare: Kanë erdhur ankesa nga familja për komunitetin rom dhe evgjyptian dhe e përmbushin kriterin familje në nevojë nëqoftëse shohim dokumentacionin. Vitin e kaluar kanë qënë përfituese vetëm ato familje. Vitin e kaluar kanë qënë 350 bursa që janë dhënë nga ministria e arsimit dhe 133 familje të tjera bursa dhe këto janë dhënë nga këshilli bashkiak. Edhe këtë vit po ndodh e njëjta situatë janë mbajtur vetëm dokumentat e atyre familjeve që janë punëkerkues por jo me ndihmë ekonomike dhe nëqoftëse shikojmë kriteret që përmbushin dhe familjet në nevojë duhet të jenë 1 deri në 2 persona duhet të kenë të ardhura 4 deri në 4 mij e 500 lekë nëqoftëse ne e dime që një familje me ndihmë ekonomike minimalja është 4 mij leke dhe maksimalja është 6 mij lek që këtu ne kemi një shkelje sepse i bie për person i bie të kenë 10 mijë lekë të vjetra deri në 15 mijë lek të vjetra. E ngrita këtë shqetësim paraprak sepse ankesat janë të shumta, kam bërë takime të ndryshme me drejtorin e drejtorisë mbështetëse dhe me specialistin i kam çuar problematikën që unë kam hasur numrin e ankesave që kanë ardhur pranë zyrës të komisionit dhe unë të them të drejtën nuk i kam çuar të gjitha ankesat por kam çuar vetëm 5 pranë zyrës të komisionit në mënyre që ta diskutojmë dhe me ju që ti japim një zgjidhje që mos dalë Bashkia e Korçës si një bashki diskriminuese. Shpresoj të marrim një zgjidhje me adhjen pranë jush të këtyre problematikave.

Kryetari i Këshillit A. Verushi: Faleminderit Eva të jesh e bindur që se cili prej nesh duam që të gjithë ta përfitojnë, unë nuk e di se sa është numri i këtij viti krahasim me vitin e kaluar por pa dashur të dal në mbrojtje të drejtoisë mbështetëse të arsimit ata patjetër që do ndjekin anën ligjore por patjetër që do e përfitojë dhe ky grup tjetër i cili nuk futet në kushtet e përfitimit për shkak të atyre që ju thatë. Në dijenin tuaj sa ka ndryshueshmëri mes numrit të atyre përfituesve të vitit të kaluar nga këtë vit ka më shumë apo më pak?

E. Tare: Ka më pak.

Kryetari i Këshillit A. Verushi: Atëherë përderisa ka më pak dhe ata do e përfitojnë.

E. Tare: I ka çuar shkolla tek drejtorja mbështetëse dhe drejtorja mbështetëse ja u ka kthyer shkollës, shkolla ja u ka kthyer familjarëve.

Kryetari i Këshillit A. Verushi: Drejtori i shkollës i mbledh të gjitha dhe i çon, selektimin nuk e bën drejtori i shkollës.

Nënkryetar K. Kita: Drejtori i shkollës i lexon ato dokumenta dhe i mbledh, tani është rasti që këta janë me ndihmë ekonomike drejtori i shkollës i mbledh i çon vetë tek zyrat përkatëse ata bëjnë seleksionimin e dokumentave i shohin të gjithë dokumentat dhe bëjnë me dije që në bazë të këtij udhëzimi nuk lejohet. Fondi vjen nga Ministira e Arsimit dhe kjo kategori është e përjashtuar dhe i gjithë fondi që vjen shpërndahet sipas kërkesave. Tani bëhet fjalë për pjesën e këtyre që janë të përjashtuar nga udhëzimi janë me ndihmë ekonomike dhe ne vjet së bashku me këshilltarët kemi miratuar nga buxheti i bashkisë një fond për të gjitha këto kërkesa që ishin bërë. Tani zonja bashkë me këshilltarin po kërkojnë që këta nxënës që nuk janë futur në kushtet e përfitimit të miratohet buxhet nga bashkia për të përfituar, ky është shpjegimi.

Këshilltar L. Petri: Zonja kryetare në vijim të axhendës të miratuar sot për mbledhjen e sotme nëse kjo që ngrita ishte për shqetësime nga komuniteti unë dua të ngre një çështje tjetër ne pika të ndryshme. Së fundmi në parlamentin Shqiptar në propozim të një grupi deputetësh nga partia socialiste është bërë kërkesë për të ndryshuar ligjin e zonave të mbrojtura gjë që i hap dritën jeshile aktivitetit ekonomik edhe në parqet kombëtare. Bashkia Korçë ka një tërësi zonash të mbrojtura por unë do përmendja më kryesoret të cilat janë parqet kombëtare që i kemi pranë edhe pse nuk janë në menaxhim të bashkisë kanë një ndikim shumë të madh në përmirësimin e ekonomisë dhe turizimit tonë siç është 'Parku i Prespës' dhe Parku Kombëtar i Bozdovecit. Unë dua të bëj apel që së pari ju të viheni në dijeni me këtë gjë, por për mua është e papranueshme që në një zonë si Bozdoveci ne të shohim atje pas disa vitesh ndërtime me beton të cilat do sjellin një fitim afatshkurtër për ato biznese që do marrin përsipër të bëjnë këto ndërtesa por në përfundim pikturën e madhe të parkut e shkatërrojnë.

Kryetari i Këshillit A. Verushi: Ju falenderoj për takimin e sotëm dhe mirë u takofshim në datën 7 dhjetor.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva Naçi

**KRYETARE
ANA VERUSHI**